

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Qytetet e Kosovës jorezistente ndaj humbjes së kujtesës kolektive

25 qershor 2014, Prizren

Në mbrëmjen e 24 qershorit 2014 (e martë) në Prizren u diskutua për potencialin e aktivizmit kulturor për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në qytetet e Kosovës. Në forumin e diskutimit **“Trashëgimia kulturore dhe aktivizmi”** organizuar nga EC Ma Ndryshe, folën Vesel Hoxhaj nga Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit, Rozafa Basha nga EC Ma Ndryshe, Eliza Hoxha, arkitekte dhe Hasan Hoti nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, ndërsa ai u moderua nga Fisnik Minci, gazetar i Koha Ditore. Gjatë forumit, panelistët dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi nevojën dhe mënyrat e organizimit qytetar për t'i mbrojtur qytetet e Kosovës nga degradimi urban.

Konstatimi qendror i diskutimit ishte se niveli i aktivizmit qytetar është shumë i ulët në raport me shkallën e degradimit të qyteteve, me theks të veçantë në shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. Panelistët dhe pjesëmarrësit e forumit reflektuan mbi përvojat e tyre të organizimit qytetar, duke i rikonfirmuar kufizimet e ndryshme që vijnë si formë e presionit politik dhe nga grupet ekonomike të interesit. Një nga dimensionet shqetësuese u tha të jetë tejpolitizimi i trashëgimisë kulturore nga viti 2004 dhe perceptimi i qytetarit si kanosës ndaj monumenteve. Një pjesë e konsiderueshme e diskutimit iu kushtua humbjes së kujtesës kolektive të qyteteve të Kosovës si paaftësi e qytetarisë për t'i rezistuar dinamikave të egra dhe të pakontrolluara të urbanizmit. Ky lloj i urbanizmit të egër shpesh shfaqet si ndërtim pa leje dhe shkatërrim i së vjetrës për të akomoduar interesa afariste. Panelistët që vinin nga autoritetet shtetërore të trashëgimisë e konfirmuan edhe një herë problemin e zbatimit të ligjit dhe mungesën e koordinimit intitucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ndër tjerash, diskutimi nxorri në pah se një pjesë e përgjegjësive për degradimin e qyteteve i takon edhe profesionistëve të planifikimit urban dhe trashëgimisë kulturore.

Ky forum i diskutimit prodhoi disa rekomandime, ndër të cilët: mobilizimi dhe rritja e presionit qytetar ndaj institucioneve për mbrojtjen e qyteteve, zbatimi i ligjeve të trashëgimisë kulturore përmes ndëshkimit të dëmtuesve, shfrytëzimi i hapësirave publike të qyteteve për aktivizëm kulturor, forcimi i kapacitetit avokues për nxitjen e politikave kulturore lokale, themelimi i sistemit të menaxhimit të pronave të trashëgimisë kulturore dhe forcimi i etikës profesionale në mesin e profesionistëve të trashëgimisë kulturore.

Forumi i diskutimit **“Trashëgimia kulturore dhe aktivizmi”** është i dyti në ciklin e pesë forumeve të diskutimit që po organizohen në baza mujore në Prizren. Këto forume janë pjesë e projektit **“Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren”**, i cili synon të nxisë debat shoqëror mbi rolin e aktivizmit kulturor në transformimin urban të qytetit. Në esencë, projekti është një nismë e intervenimit kulturor dhe artistik që synon t'i trajtojë në mënyrë kreative sfidat e zhvillimit

urban dhe reformës demokratike në Prizren. Përveç forumeve të diskutimit, gjatë vitit 2014 pjesë e këtij projekti do të jenë edhe këto aktivitete: hulumtimi mbi potencialin e aktivizmin kulturor dhe urban në Prizren, intervenimet artistike në hapësirën publike, platforma virtuale për blogging kulturor dhe konferenca rajonale për shkëmbimin e përvojave mes aktivistëve kulturor nga shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ju falemnderit.

Me respekt,
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Perandori Dioklician 14 (kati V) Prishtinë & Saraqët 5, 20000/Prizren
038 224 967 & 029 222 771
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

"Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."

